

AKT-THEMELIM
I
SHOQËRISË

BLUE VISION sh.p.k.

Ne mbështetje të Ligjit Nr.9901,dt. 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”,
UNE, :

1-Bekim Onuzi i biri i Rakip-it e datelindjes 23-12-1991, lindur e banues ne Nange i paisur me leternjofitim me Nr.J11223025D.

Sot me dt. 09/02/2024, me vullnetin tim të lirë dhe të plotë, vendosa të hartojë këtë Akt-
Themelimi për krijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar **BLUE VISION**
sh.p.k. si

ORTAKET.

Akti i Themelimit hartohet me këto kushte:

Neni 1

Ortaku , me gjeneralitetet e mësipërme, me vullnet të lirë dhe të plotë krijoj Shoqërinë me
Përgjegjësi të Kufizuar **BLUE VISION** sh.p.k. .

Neni 2

Shoqëria vepron në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi që rregullon mënyrën e
organizimit dhe funksionimit të shoqërive tregtare dhe në përputhje me dispozitat e Statutit që i
bashkëlidhet këtij Akt – Themelimi.

Neni 3

Emri i plotë i shoqërisë është **BLUE VISION** sh.p.k. .

Neni 4



Selia e shoqërisë është në **Kukes, Kukes, Fshati Nange, Lagjja Onuzi, Rruga Nacionale Kukes-Peshkopi Km.15, Zona Kadastrale Nr.2762, Nr.Pasurie 227/12.**

Sipas dispozitave të përcaktuara në Statut dhe në Akt – Themelimit, veprimtaria e shoqërisë do të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj, duke krijuar filialet apo degët e saj.

Neni 5

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar **BLUE VISION** sh.p.k. do të jetë ai i përcaktuar në Statutin e Shoqërisë :

Krijimtari artistike.Produksion.Import-eksport.

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë **100.000 (njëqind mijë) leke** ndare në 1 kuote . Kapitali themeltar mund të rritet sipas dëshirës së ortakut dhe kushteve në të cilat ushtron veprimtarinë, në formën dhe mënyrën e parashikuar në Statut.

Neni 7

Administrator i Shoqërisë do të jetë **Z.Bekim Onuzi** dhe kompetencat e tyre përcaktohen në Statut.

Neni 8

Viti financiar i Shoqërisë mbyllet me 31 Dhjetor, ora 24^{oo} te çdo viti kalendarik. Bilanci vjetor i veprimtarisë së shoqërisë përfundohet brenda muajit Mars të vitit të pasardhës.

Neni 9

Shoqëria gëzon lirisht pronat dhe mjetet e saj financiare dhe ka të drejtë ti përdorë ato në përputhje me objektin dhe qëllimin e veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 10

Ky Akt–Themelim do të jetë efektiv nga dita e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar. Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat të caktuar.

Për Shoqërinë

BLUE VISION shpk

ADMINISTRATORI

Ortaku

Bekim Onuzi